

**VENDIM**  
**Nr. 982, datë 25.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE,**  
**PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË**  
**FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT<sup>1</sup>**  
*(Ndryshuar me VKM nr.99, datë 23.2.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e zëvendëskryeministrit, kryetar të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. *Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:*

- *Z. Artan Shkreli, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;*
- *Znj. Albana Shkurta, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;*
- *Z. Hajrulla Çeku, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit;*
- *Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER).*

3. Vendimi nr. 1293, datë 29.12.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

---

<sup>1</sup> VKM nr. 982, datë 25.10.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, 7 nëntor 2013.  
VKM nr.99, datë 23.2.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.27, 2 mars 2018.